



Cilat shkolla marrin pjesë në vlerësimet për lëndën e shkencës?

Të gjitha shkollat e drejtorisë arsimore marrin pjesë në testimet e vlerësimit për lëndën e shkencës. Shkollat jopublike dhe private gjithashtu mund të marrin pjesë mbi baza vullnetare.

Cilët nxënës i nënshtrohen këtij vlerësimi?

Të gjithë nxënësit në klasat 4, 8 dhe të klasës 11 do të përfshihen në këto vlerësime (përveç nxënësve që përmbushin disa kritere specifike).

Kur bëhen testimet për këto vlerësime?

Vlerësimet planifikohen nga drejtoria arsimore për t'u mbajtur brenda periudhës 27 Prill deri në 8 Maj të vitit 2009.

Sa është kohëzgjatja e këtyre vlerësimeve?

Kohëzgjatja e plotë e testimit në lëndën e shkencës është afërsisht nga dy deri në katër orë. Drejtoria arsimore duhet t'ju informojë mbi planifikimin e datës së kryerjes së këtyre vlerësimeve.

Çfarë përfshihet në testet e vlerësimit?

Nxënësit e klasave 4 dhe 8 përfundojnë dy seksione me pyetje për vlerësimin e lëndës së shkencës; nxënësit e klasës së 11 përfundojnë tre seksione. Disa nga këto seksione me pyetje do të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit dhe disa seksione do të konsistojnë me grupe ushtrimesh të ndryshme.

Kush i administron testimet për këto vlerësime?

Çdo shkollë zgjedh personin(at) e vet, të cilët do të administrojnë testin. Në shumicën e rasteve, këta janë mësuesit e shkollës, të cilët shpesh ndihmohen nga drejtori i shkollës ose një këshilltar drejtues i vlerësimeve.

Çfarë lloje pyetjesh përfshihen në testimet e vlerësimit?

Nxënësit u përgjigjen dy lloje pyetjesh: pyetje me zgjedhje (*multiple choice*) dhe pyetje që kërkojnë zhvillim (*open ended*). Në pyetjet me zgjedhje, përgjigja e saktë zgjidhet nga katër opsionet e paraqitura, ndërsa pyetjet me zhvillim kërkojnë nga nxënësit të hartojnë përgjigjet e tyre. Për klasat 8 dhe 11, testi përfshin gjithashtu edhe skenarë shkencor.

Çfarë është një skenar në lëndën e shkencës?

Skenari në këtë lëndë përmban tekstin, grafikët, dhe tabelat, elementë që do të përdoren për të përshkruar rezultatet e një projekti në klasë, një eksperimenti, ose të tjera kërkime të ngjashme. Nxënësit përdorin informacionin e dhënë në skenarin shkencor, në mënyrë që t'u përgjigjen të dyjave, pyetjeve me zgjedhje dhe me zhvillim. Skenarët në këtë lëndë do të përdoren vetëm për klasat e 8^{ta} dhe 11^{ta}.

Si bëhet vlerësimi i pikëve për përgjigjet me shkrim të pyetjeve me zhvillim?

Përgjigjet me shkrim për pyetjet me zhvillim në lëndën e shkencës bëhet nga vlerësues që janë trajnuar në zbatimin e një sistemi vlerësimi të paracaktuar më parë. Në lëndën e shkencës, pikët bazohen vetëm në përmbajtje. Drejtshkrimi dhe shenjat e pikësimit **nuk** përfshihen në procesin e sistemit të vlerësimit.

Kush vendos se çfarë duhet të testojë ky vlerësim?

Grupe mësuesish nga të gjitha nivelet e arsimit në Pensilvani zgjedhin fushat e njohurive mbi të cilat do të bazohen këto vlerësime. Në këto grupe u përfshin mësues, metodist, drejtues të kurikulës dhe specialist të kolegjeve. Po këto grupe rishikuan, redaktuan dhe aprovuan pyetjet, të cilat u shkruan në përputhje me Shpjeguesit e Standardeve të Vlerësimit të Pensilvanisë.

Çfarë vlerësohet në lëndën e shkencës?

Vlerësimi në lëndën e shkencës përfshin katër kategori kryesore: Natyra e Shkencës, Shkencat Biologjike, Shkencat Fizike dhe shkencat e Hapësirës dhe Tokës. Ndarja proporcionale e pyetjeve për secilën kategori të veçantë ndryshon brenda secilës klasë/vit. Secila kategori përfshin testimin e elementeve specifik sipas Shpjeguesve të standardeve të vlerësimit dhe brenda asaj përmbajtje, temave (*Eligible Content*) të caktuara për t'u dhënë në test.

Si bëhet raportimi i rezultateve?

Raportet e rezultateve të vlerësimit për testin e lëndës së shkencës dërgohen në drejtorinë arsimore për t'u shpërndarë prindërve, mësuesve, këshilltarëve udhëheqës të këtyre testeve, si edhe drejtorëve. Shteti nuk merr ndonjë raport me emrat e individëve pjesëmarrës në testet e vlerësimit.

Rezultatet raportohen sipas shkollave, për arsye të analizave të planeve dhe programeve mësimore. Drejtorinë arsimore botojnë rezultatet e vlerësimit të testit PSSA për secilën shkollë. Shteti gjithashtu nxjerr të dhënat e vlerësimeve për çdo shkollë.

A mund t'i shikojnë prindërit rezultatet e vlerësimeve?

Prindërit dhe kujdestarët mund të rishikojnë vlerësimet duke planifikuar një takim me koordinatorin e vlerësimeve të shkollës, me të arritur këto rezultate në shkollë. Kopje të vlerësimeve ose shënimet rreth pyetjeve nuk lejohet të dalin jashtë shkolle pa leje dhe gjithashtu midis palëve nënshkruhet një marrëveshje besimi.

Nëse, pasi është bërë rishikimi i vlerësimeve, prindërit, të cilët nuk do të duan që fëmija e tyre të marrë pjesë në testin e vlerësimit për lëndën e shkencës, për arsye besimi fetar, ata mund të dërgojnë një shënim me shkrim shefit të rajonit të drejtorisë arsimore, përpara se të fillojë administrimi i këtij vlerësimi, për të justifikuar mos pjesëmarrjen në këto vlerësime.